

© Beate Frenzel, Gülşah Mavruk (2018)

Udhësues bisedash për bisedën e parë me nxënës dhe nxënës të sapoardhur/a

Shpjegime për formatin e mbledhjes së informacioneve

(Albanisch – Übersetzung durch externen Anbieter)

Formati i mbledhjes së informacioneve i parashtruar është synuar si një udhësues bisedash dhe si një informacion bazë për shkëmbimin kolegjal për mësueset dhe mësuesit, të cilët/at merren me biseda pranuese me fëmijë dhe adoleshentë të sapoardhur.

Në biseda të tilla pranuese duhet pasur parasysh, që ato i shërbejnë vetëm një orientimi resp. një drejtimi të parë në grupe mësimi, dhe që nuk mund të sqarohen menjëherë të gjitha pyetjet interesante të organizimit shkollor. Ky kufizim u përket në veçanti temave si familja, arratisja dhe statusi i qëndrimit, thellimi i të cilave mund të shkaktonte kthime në të kaluarën tek nxënëset dhe nxënësit e traumatizuar/a. Por gjithashtu pyetjet e financimit, të cilat kanë rëndësi për parashtrimin e kërkesave për orë nxitjeje dhe për BuT-Maßnahmen (masa shkollimi dhe pjesëmarrjeje), duhet të bëhen tema e bisedës vetëm atëherë, kur tashme mund të krijohej një raport besimi mes mësueseve dhe mësuesve, nxënësve dhe nxënësve, prindërve, përgjegjësve ligjorë ose kujdestareve dhe kujdestarëve si dhe mes punonjëseve sociale dhe punonjësve socialë të shkollave.

Pikat veç e veç të formatit të mbledhjes së informacioneve duhen formuluar dhe përshtatur sipas moshës dhe sipas njohurive gjuhore të nxënësve të ardhshme dhe nxënësve të

ardhshëm. Jo çdo pyetje i përshtatet çdo fëmije ose çdo adoleshenti. Vendimi për këtë është në vlerësimin e mësuesve dhe mësuesve pranues/e.

Formati i mbledhjes së informacioneve skicon thelbin e orientimit pas burimeve. Në zbatim të këtij, të gjitha burimet gjuhore të nxënësve dhe nxënësve duhet të dokumentohen. Në pjesën III (Praktika gjuhore në vendin e origjinës), duhet të zbulohet përdorimi i gjuhës në rrethana të veçanta. Në këtë, të gjitha aftësitë e veçanta (të folurit, të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit) mund të merren parasysht.

Në plotësim të formatit të mbledhjes së informacioneve, përvoja shkollore dhe profesionale të mëparshme, interesa dhe dhunti të fëmijëve dhe adoleshentëve të sapoardhur do të pyeten në gjuhë të ndryshme origjine. Kjo lejon një drejtim në grupe mësimi, i cili nuk orientohet vetëm tek gjendja aktuale e njohurisë gjuhore, por edhe tek motivimi dhe potenciali i të prekurve.

Dëftesa eventuale ekzistuese nga vendet e origjinës mund të shqyrtohen tek Qeveria e Rajonit Köln, nëse ekziston mundësia e njohjes së një diplome shkollore deri në një diplomim të mesëm shkollor.

http://www.bezreg-koeln.nrw.de/brk_internet/leistungen/abteilung04/48/erkennungung/auslaendische_schulzeugnisse/index.html

Përkundrazi, për njohjen e Maturës së Përgjithshme, përgjegjësinë e mban Qeveria e Rajonit Düsseldorf.

http://www.brd.nrw.de/schule/schulrecht_schulverwaltung/Zeugnisanerkennung.html

Një listë literature e komentuar me libra mësimi dhe materiale shtesë për mësimdhënien me nxënës dhe nxënës të sapoardhur/a gjeni në një link në faqen e internetit ProDaZ <https://www.uni-due.de/prodaz/>.